

BULETINI
VJETOR
FORUMI RINOR ISLAM

20

23



Rr. Çairska nr.1, 1000 Shkup
Maqedonia e Veriut

E: info@fri.org.mk

w: www.fri.org.mk

Botues: Forumi Rinor Islam

Përgatiti: Zyra për marrëdhënie me publikun

Ebrar Sherifi, Zulejha Ramadani, Demir Kasami, Aishe Emini, Edin Isaki, Zejnep Ramadani

Fotografitë: Ebrar Sherifi, Bujar Alili, Zejnep Ramadani

Dizajni: Ebrar Sherifi, Zejnep Ramadani

Shkurt 2024

PËRMBAJTJA

Fjalimi i kryetarit dhe shtrirja e FRI-së	04
Struktura organizative dhe KQ	06
Ligjërata fetare	08
Fushata	12
Bursa për nxënës dhe student	14
Platforma “Mozaiku rinor”	16
Manifestimi “Në gjurmët e më të mirëve”	20
Ramazani, muaji i arritjeve	26
Shkolla edukative “Haxhi Nazim Xhaferri”	32
Aktivitetet e brenshme	34
Takime rinore	36
Shëtitje dhe kampingje	37
Vizita	38
Aktivitetet e ZMP	39

Të nderuar,

Forumi Rinor Islam, me dëshirën dhe ndihmën e të madhit Zot, hapi dekadën e tretë të veprimtarisë së vet. Periudha që e lamë pas jo që nuk kishte sfida dhe probleme, por vullneti, dëshira, përkushtimi dhe vizioni i qartë i anëtarëve dhe aktivistëve të kësaj organizate, si dhe mbështetja juaj materiale dhe shpirtërore ishin shtytëset kryesore që ne mos ndalemi në realizimin e planit tonë strategjik, i cili plan qëllim kryesor ka ngritjen edukative dhe aftësuese si dhe ruajtjen e tyre nga devijimet e ndryshme që na i sollën faktorë të shumtë në kohën që jetojmë.

Viti 2023 erdhi me shumë mundësi të reja të cilat arritën të menaxhohen në mënyrën më të mirë të mundshme nga ekipi ynë i mrekullueshëm dhe mbështetja e donatorëve tanë të nderuar. Këtë vit, më duhet të them se jam krenar që FRI përsëri u prezantua para të rinjve (fillorist dhe gjimnazist) me platformën shumë tërheqëse "MOZAIKU RINOR", ku përfshihej aktiviteti EUREKA, INCEPT dhe TALENTIUM, projekte në të cilat pjesëmarrës ishin të rinjë nga gjashtë qytete ku vepron FRI si: Kumanovë, Shkup, Tetovë, Gostivar, Kërçovë dhe Prilep të cilët patën mundësinë të trajnohen nga trajnerë të dalluar me tema dhe sfera të ndryshme.

Bursat e nxënësve dhe studentëve janë gjithashtu një pjesë e rëndësishme e planit tonë të veprimit që arritëm ta shtojmë këtë vit falë ndihmës së Zotit dhe mbështetjes së donatorëve tanë. Përveç që janë lehtësim material për nxënësit dhe studentët, përkatësisht për prindërit e tyre, ato janë edhe kënaqësi dhe mundësi për avancim arsimor dhe formues, sepse me ta realizojmë trajnime të ndryshme, edhe në fusha të ndryshme.

Nuk kanë munguar as ligjëratat e hapura me nxënës dhe studentë që mbahen në disa degë si: Shkup, Kumanovë, Tetovë, Kërçovë dhe Prilep, me qëllim që të trajtohen disa tema aktuale që i shqetësojnë, qoftë gjatë mësimëve apo studimeve, apo tema të përditshme të jetës, me pedagogë dhe influencues të dalluar mes të rinjëve.

Për të 23-tën herë radhazi, këtë vit realizuam me sukses aktivitetin e hixhretit nën moton "Në gjurmët e më të mirëve", ku përveç shpalljes së nxënësve dhe studentëve më të dalluar të brezit nga shkollat e mesme të vendit dhe univerzitetëve, ka pasur edhe një program kulturor e artistik me figura të njohura në vendin tonë dhe më gjerë.

Gjatë vitit që lamë pas, FRI vazhdoi aktivitetin me target grupin e saj më të rëndësishëm, të rinjtë, mbi të cilin zhvilloi diskutime të hapura me të rinjtë për të trajtuar tema që i prekin, me psikologë dhe teologë të ndryshëm. Një program i veçantë, si vitet e kaluara, edhe këtë vit FRI shënoi Ramazanin me aktivitete të ndryshme me qëllim sensibilizimin e publikut për shfrytëzimin e kësaj mundësie të veçantë, për ngritje shpirtërore. Nuk munguan as vizita dhe ekskursionet me të rinjtë brenda dhe jashtë vendit, me qëllim rekreacionin dhe njohjen e të rinjve tanë me vende dhe kultura të tjera, si dhe afrimin e tyre me njëri-tjetrin.



Mr. Xhabir EMINI, kryetar

FRI poashtu ka një platëformë të qartë mediatike. FRI është shumë aktive në media ku përveç aktiviteteve, fushatave dhe projekteve të saj të përgjithshme shpërndan edhe përkujtime të përditshme në rrjetet sociale. FRI në mund ta gjeni në Youtube, Facebook, Instagram, TikTok, si dhe në disa media lokale (tv dhe radio).

Ne besojmë fuqishëm se FRI ka kapacitetet dhe mundësitë për të kryer shumë më tepër nga aktivitetet që prezantojmë në këtë buletin, veçanërisht kur kemi parasysh përvojën dhe ekipin e mrekullueshëm që janë të mbushur me një vullnet dhe entuziazëm të madh që duhet ndjekur. Megjithatë, duke marrë parasysh krizat, sfidat dhe problemet që po kalon shoqëria jonë tani, jam i lumtur që arritëm objektivin që vendosëm në fillim të vitit, dhamë maksimumin për të kontribuar sadopak në përmirësimin e shoqërisë duke ndërgjegjësuar të rinjtë. Dhasht Zoti që këto aktivitete t'ju kenë bërë dobi shoqërisë sonë në përgjithësi, kurse rinisë në veçanti.

Falënderojmë Allahun e Madhëruar që na mundësoi të zhvillojmë aktivitete të ndryshme me shtresën më të rëndësishme të shoqërisë, rininë. Më pas falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan drejtpërdrejt ose indirekt në realizimin e planit tonë vjetor, veçanërisht donatorët, anëtarët, aktivistët dhe të gjithë partnerët tanë.

Zoti i Madhëruar na dhashtë punë të mbarë!

Amin!

SHTRIRJA E FORUMIT RINOR ISLAM

Kumanovë

Rr. Karl Marks nr.60
1300, Kumanovë

Shkup

Rr. Çairska nr.1
1000, Shkup

Tetovë

Rr. Jane Sandanski nr.64
1220, Tetovë



Gostivar

Rr. Sedek Kostovski nr.19
1000, Shkup

Kërçovë

Qendra Tregtare H/R
Arabella
1300, Kërçovë

Prilep

Fsh. Cërnilishtë
7516, Prilep

VIZIONI YNË:

Forumi Rinor Islam të jetë udhëheqës në fushën e veprimtarisë rinore, shembull i organizatës së suksesshme në zhvillimin e gjithëmbarshtëm shpirtëror, material, kulturor dhe moral të shoqërisë; organizatë e afirmuar në vend dhe arenën ndërkombëtare në hap me proceset integruese

MISIONI YNË:

Promovimi dhe kultivimi i vlerave universale Islame dhe njerëzore, mbrojtja e të rinjëve nga devijimet si dhe ngritja dhe aftësimi i tyre.

POLITIKAT TONA:

- Fokusimi në çështjet prioritare
- Maturia dhe gradualiteti në veprim
- Disiplina në realizimin e detyrave
- Dialogu dhe partneriteti
- Mbrojtja e identitetit kulturor
- Fuqizimi i të rinjëve

VLERAT TONA:


- Besimi
- Përpikshmëria
- Mesataria
- Vetëmohimi
- Objektiviteti
- Uniteti
- Toleranca
- Mirëkuptimi
- Bashkëpunimi
- Puna institucionale

QËLLIMET STRATEGJIKE:

- Avancimi i punës rinore
- Avancimi i punës edukative
- Ngritja e kapaciteteve kadrovike dhe institucionale
- Promovimi në media dhe opinionin publik
- Bashkëpunimi me institucione shtetërore dhe ndërkombëtare, akademike, arsimore, OJQ dhe medime
- Qëndrueshmëria financiare e FRI-së

FORUMI RINOR ISLAM

STRUKTURA ORGANIZATIVE





MR. XHABIR **EMINI**

KRYETAR



ABDULHAMID MUSTAFA
SEKRETAR GJENERAL
&
PERGJEGJËS
DEP. PËR ZHVILLIM TË BRENDSHËM

ZULJETA FETAI
NËNKRYETARE

MR. VULLNET SELMANI
NËNKRYETAR
&
PERGJEGJËS
ZYRA PËR PROJEKTE




ERDUAN KURTISHI
KRYETAR - KUMANOVE
&
PERGJEGJËS
DEP. I FUSHATAVE



AFRIM DEMIRI
KRYETAR - SHKUP



MEVLAN ABAZI
KRYETAR - TETOVE
&
PERGJEGJËS
DEP. I EDUKIMIT



ZURIJET SULEJMANI
KRYETAR - GOSTIVAR



SHUKRI SADIKU
KRYETAR - KËRÇOVË



VETON IBRAHIMI
KRYETAR - PRILEP



MEDIN BAJRAMI
ANËTAR



SAMIR MUSTAFA
ANËTAR



ERMIRA IDRIZI
PERGJEGJËSE
DEP. PËR TË RINJ



EMINE ALIMI
ANËTARE



VALMIRA ABAZI
ANËTARE



EBRAR SHERIFI
PERGJEGJËS
ZYRA PËR MARRËDHËNIË
ME PUBLIKUN

LIQJËRATA TË FETARE



FLEKSIBILITET
PËR KUALITET

Pjesë e pandashme e aktiviteve të Forumit Rinor Islam janë edhe ligjëratat e vazhdueshme fetare, përmes së cilave synojmë ngritjen e vetëdijes fetare, si dhe edukimin fetar të masës, duke vënë në fokus këtu rininë.

Ndër këto takime janë:

- Ligjërata me titullin **“Të shumtë besojnë destinacionin e dynjas, por pak përgatiten për të”** që u trajtua nga kryetari i FRI-së, Xhabir Emini, përpara të rinjve në degën e Prilepit.

- **“Të rinjtë i pret Xhenneti”** me hoxhën Shaban Tairi, që u realizua në qytetin e Shkupit.

- **“Roli i fesë në zhvillimin e vizionit të arsimit”**, me profesor Naser Ramadani. Ky takim u realizua me rastin e Ditës së Mësuesit, me të rinjtë nga qyteti i Shkupit.

- Tribuna **“Në kërkim të kuptimit”**, me profesor Halis Aydemir, nga Republika e Turqisë, i cili ligjëroi në Teatrin Shqiptar në Shkup.

- **“Roli i besimtarit përball zhvillimit të botës”** me hoxhë Vladimir Kera, që u realizua në Qendrën e FRI-së në Shkup.


- **“Rinia mes krenarisë dhe dëshpërimit”**, të cilën e ligjëroi hoxhë Hasan Baftijari, në qytetin e Shkupit.

- **“Allahu e di çfarë ka në zemra”**, me hoxhë Ismet Tahiri, në qytetin e Tetovës. Me këtë ligjëratë filloi cikli i ligjëratave dyjavor në degën e Tetovës.





- **“Obligimet e myslimanit bashkëkohorë”**, me hoxhën Mevlan Abazi, kryetar i FRI- dega Tetovë.
- **“Vlerat që e ndërtojnë myslimanen”**, me teologe Sumeja Peza. Me këtë ligjëratë filloi realizimi i takimeve mujore me motrat në qytetin e Shkupit.
- Cikli i ligjëratave **“Drejt kënaqësisë së Zotit”**, që realizohet në qytetin e Shkupit. Ligjëratat e parë e këtij cikli ishte ligjëratat **“Moralit i myslimanit bashkëkohor”**, me hoxhë Zija Ismaili.
- Seminari **“Rizgjimi shpirtëror”**. Gjatë këtij seminari dyditorë, që u realizua në Shkup, u trajtuan disa tema me një numër të madh të të rinjve. Temat që u realizuan në këtë seminar ishin: **“Njohja me Zotin”** me hoxhë Fevzi Musliu, **“Kurani si udhërrëfyes i jetës”**, me hoxhë Shaban Tairi, **“Rëndësia e traditës profetike në jetën tonë”** me hoxhë Omer Dauti, **“Pastërtia e zemrës”** dhe **“Rëndësia e kërkimit të diturisë”** me Sumeja Peza dhe ligjëratat e fundit **“Si duhet të jetë portreti i të riut mysliman?”** me hoxhë Zija Ismaili.



- **“Roli dhe rëndësia e shkencës së hadithit”**, me hoxhë Festim Kasami, që u realizua si pjesë e takimeve dyjavore të Tetovës.

- **“Si të gjejmë kuptimin e jetës”**, që u realizua me motrat nga qyteti i Tetovës me teologe Sumeja Peza.

- Ligjërata për motrat me titullin **“Asja e ditëve të sotme”**, me teologe Esma Sherifi, realizuar nga departamenti i edukimit pranë FRI – dega Shkup.

- **“Siguroni kiblën e jetës”** të cilën e ligjëroi hoxhë Zija Ismaili përpara të rinjve nga qyteti i Shkupit.

- **“Sekretet e përballjes me sfidat dhe arritjes së ndryshimit”** me hoxhë Fevzi Musliu, që u realizua në Tetovë, si pjesë e takimeve dyjavore.

- Ligjërata **“I riu i lidhur me Zotin”** me hoxhë Fevzi Musliu, i cili ligjëroi në degën e FRI-së në Kumanovë. Me këtë ligjëratë filloi realizimi i ciklit të ligjëratave dyjavore në qytetin e Kumanovës.

- **“Islami, nevojë e civilizimit bashkëkohor”**, me mr. Xhabir Emini, që u realizua si pjesë e takimeve të rregullta në qytetin e Shkupit.

- Ligjërata me titullin **“Vepra e mirë”**, me hoxhë Azir Avdiu, i cili ligjëroi në qytetin e Kumanovës. Kjo ligjëratë u realizua si pjesë e takimeve dyjavore të FRI – dega Kumanovë.



- **“Nën hijen e ajeteve të sures Jasin”** me teologe Sumeja Peza, ligjëratë që u realizua si pjesë e takimeve mujore me motrat nga qyteti i Shkupit.

- Ligjëratat me hoxhën e mirënjohur Halil Avdulli, i cili ligjëroi rreth temës **“Katër veçoritë themelore të njeriut në Kuran”** në Qendrën e FRI-së në Shkup, dhe **“Çlirimi i njeriut në Kuran”** në qytetin e Kumanovës.





FUSHATA

 
*Prova Shaminë
për një ditë*
FORUMI RINOR ISLAM - DEGA KUMANOVË

Gjatë vitit 2023, Forumi Rinor Islam ka qenë prezent në organizime të kampanjave, duke filluar nga shënimi i ditëve të veçanta, udhëheqja e fushatave të ndryshme, aktiviteti i dhurimit të gjakut.

Ndër këto aktivitete janë:

- Aktiviteti **“Provo shaminë për një ditë”**. Ky është një aktivitet i realizuar nga FRI – dega Kumanovë me rastin e 1 shkurtit, Ditës Botërore të Mbulesës. Aktivistet e FRI-së u vendosën në qendrën e qytetit për të kalimtare e rastit në vendosjen e shaminë.


- **“Anëtarësohu te Forumi Rinor Islam”**

FRI – dega Shkup hapi dyert për nxënësit e shkollave të mesme që të anëtarësohen në organizatën tonë. Përgatitja edukativo-fetare, zhvillimi i aftësive organizative, pjesëmarrja në trajnime janë disa nga aftësitë dhe mundësitë që i ofron FRI.

- Përmes postimeve në rrjetet sociale janë përkujtuar **ditët e veçanta kombëtare dhe fetare**, si: Dita e Pavarësisë së Kosovës, Dita e Mësuesit, Dita e Masakrës së Srebrenicës, Ditëlindja e Muhamedit (alejhi salam), Dita e Alfabetit, Dita e Flamurit,

- **“Të nxisim dijen, të investojmë për ardhmërinë”**, apo aktiviteti i shpërblimit të semi-maturantëve në të mirë, ishte një aktivitet i realizuar nga FRI – dega Tetovë në të cilin u dekoruan 23 nxënës të shkollave fillore të Tetovës dhe komunave përreth. Përzgjedhja e nxënësve u bë nga ana e shkollave, ndërsa FRI shpërbleu nxënësit me lëvdata, nga një pako me libra nga shtëpia botuese “Furkan ISM” si dhe një shumë modeste të të hollave.

- **“Dhuro gjak, shpëto jetë”** është aktivitet që realizohet nga FRI – dega në Kërçovë në bashkëpunim me Kryqin e Kuq dhe Institutin e Transfuziologjisë. Ky aktivitet realizohet disa herë brenda vitit dhe është një nga aktivitetet më të suksesshme të këtij lloji në qytetin e Kërçovës.





Bursa për nxënës dhe student STUDENTORE

Apliko edhe ti!

KONKURS PËR
BURSA PËR VITIN
AKADEMIK 2022/23

Afati dorëzimit (pranimi) të
dokumenteve bëhet prej
07.09.2022 deri më

BURSA PËR NXËNËS DHE STUDENT

Forumi Rinor Islam, ndër aktivitetet e shumta që realizon me nxënës dhe studentë, është edhe aktiviteti i bursave, një aktivitet ky që ndihmon në stimulimin e dijes dhe përkrahjen e studentëve.

Me fillimin e vitit shkollor, FRI hap konkursin dhe fillon të pranojë aplikimet e nxënësve dhe studentëve për bursa, të cilat aplikime shqyrtohen dhe caktohen nxënësit dhe studentët të cilëve do të ju ndahen bursat në bazë të kushte të paracaktuara. Bursa ndahen për nxënës të shkollave të mesme dhe studentë të universiteteve në Maqedoninë e Veriut dhe studentë që studiojnë jashtë vendit.

Përveç bursave mujore që ju ndahen nxënësve dhe studentëve të përzgjedhur, FRI realizon një sërë aktiviteteve me to, duke filluar nga ligjëratat dhe takimet rimore, iftare dhe takimet të ndryshme gjatë Ramazanit, tribuna, shëtitje e kampingje.





**MOZAIKU
DINOR**

PLATFORMA “MOZAIKU RINOR”

Platforma “Mozaiku Rinor” mbetet një nga aktivitetet kryesore të Forumit Rinor Islam që e realizon me të rinjtë. Kjo platformë përbëhet nga 3 projekte rinore, që realizohet në degët e Forumit Rinor Islam gjatë gjithë vitit akademik. Gjatë realizimit të këtyre projekteve trajnohen tema të ndryshme në bazë të projektit dhe trajnues në këto tema janë profesionalistë të fushave të ndryshme, të aftë për të mbajtur interesin e nxënësve gjatë trajnimeve.

- **“Eureka”** realizohet me nxënësit e klasave të nënta. Këtë vit realizimi i këtij projekti u bë gjatë 6 të shtunave të gjysmëvjetorit të parë, duke trajtuar tema si: **“Teambuilding”**, **“Të jetuarit shëndetshëm”**, **“Të mësuarit efektiv”**, **“Rrjetet sociale”**, **“Modeli i një të riu të suksesshëm”**, **“Reagimi në emergjencë”**. Trajnues të këtyre temave ishin: Arsim Jonuzi, Kujtesa Xheladini, Liridon Ismaili, Afrim Demiri, Zuhri Kamberi, Zuhri Kamberi, Abdulhamid Mustafa, Zuriyet Sulejmani, Munibe Qamili, Latife Nuredini, Lavdrim Mehmedi, Mirhat Aliu, Sara Ajro, Esmir Selmani.



- **"Incept"** është projekti që realizohet me nxënësit e viteve të para dhe të dyta të shkollave të mesme. Temat që trajtohen në këtë takime me nxënësit janë: **"Teambuilding"**, **"Bullizmi"**, **"Menaxhimi i vetes në kohë"**, **"Ndikimi i rrjeteve sociale në shëndetin mental"**, **"Teknika të të mësuarit"**, **"Inteligjenca emocionale"**, me trajnues si: Bunjamin Selimi, Liridon Ismaili, Arsim Jonuzi, Zeqir Esati, Kujtesa Xheladini, Afrim Demiri, Gilmane Osmani, Abdulhamid Mustafa, Ebrar Sherifi, Zurijet Sulejmani.



- **"Talentium"** është projekti që realizohet me nxënësit e viteve të treta dhe të katërta. Fokusi i këtij projekti është përgatitja e nxënësve në shkencat e komunikimit dhe të medias. Temat që trajtohen në këtë projekt janë: **"Komunikimi verbal dhe joverbal"**, **"Arti i të folurit publik"**, **"Rregullat e debatit"**, **"Komunikimi nëpërmjet kamerës"**, **"Strategjitë e përgatitjes së fjalimit"**, **"Leadershipi"**.

Ligjërues të këtyre temave janë: Afrim Demiri, Bujar Idrizi, Fuad Jonuzi, Arsim Jonuzi, Besar Bekiri, Kujtim Kasami, Agron Vrangalla, Fisnik Shabani, Berat Limani, Liridon Ismaili, Bunjamin Selimi, Eren Ali, Valon Elezi.

Si pjesë e këtyre projekteve janë vizitat që realizohen nëpër institucione të ndryshme, dhe shëtitjet e aktivitetet rekreative me nxënësit.





NË GJURMËT E MË



TË MIRËVE 1445-2023

MANIFESTIMI "NË GJURMËT E MË TË MIRËVE"

Manifestimi "Në gjurmët e më të mirëve", tashmë një aktivitet tradicional i Forumit Rinor Islam, që realizohet që 23 vite, u realizua edhe këtë vit për të përkujtuar një ngjarje madhore të historisë, Hixhretin e Pejgamberit Muhammed (alejhi selam). Këtë vit ky aktivitet u mbajt në Teatrin Kombëtar Maqedonas në Shkup.



Manifestimi filloi me leximin e disa ajeteve kuranore nga hafëzi Fatih Derdiyok nga Republika e Turqisë.



Fjalë rasti kishte nikoqiri i këtij aktiviteti, kryetari i FRI-së, mr. Xhabir Emiri, i cili përshëndeti të pranishmit dhe ju uroi mirëseardhje.



Qëllimi kryesor i këtij manifestimi është stimulimi i diturisë e shkencës dhe nxënia e dijes, dhe mu për këtë pika kryesore e këtij manifestimi është dekorimi nxënësve dhe studentëve më të dalluar.

Nga shumë shkolla të mesme të qyteteve të Republikës së Maqedonisë u dekoruan nxënësit më të mirë. Po ashtu u dekoruan edhe studentët më të dalluar të fakulteteve të ndryshme nga universitetet: Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik, Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi", Universiteti i Tetovës.

Me çmimin "Hafëzi i ri i vitit" u dekorua 11 vjeçari hafëz Dijar Ibraimi nga qyteti i Shkupit. Ndërkaq si rezultat nga konkursi të shpallur në rrjetet sociale, çmimi "Shkencëtare e re e vitit" iu nda Prof. Dr. Arlinda Amiti.



U bë edhe dekorimi i disa personaliteteve dhe subjekteve për kontribut dhe arritje të veçanta. Me dekoratën "Post mortum" u dekorua Prof. Dr. Nazmi Maliqi, ndërkaq të dekoruarit tjerë ishin: futbollist Besart Ibraimi, autoshkolla "Hirda", prof. Hasan Zilbeari, hafëz Sadudin Sulejmani.





Si çdo vit, edhe kësaj radhe ky manifestim ishte i pasur edhe me disa pika artistike.

Monologun e shkruar nga Arsim Jonuzi me titull "Jep ujë" e interpretoi Zuriyet Sulejmani, ndërkaq si ilahi enkas për këtë manifestim ishte ilahia e interpretuar nga Nderim Alimi me titull "Lotët e Muhammedit a.s." dhe ilahia e mirënjohur "Allah".




**MANIFESTIMI "NË GJURMËT E MËTË MIRËVE"
HIXHRI 1445**

NË GJURMËT E MËTË MIRËVE

TEATRI KOMBËTAR MAQËDONAS - SHKUP
25.10.2023 (E MËRKUR)





RAMAZANI

muaji i arritjeve

1444 | 2023



RAMAZANI, MUAJI I ARRITJEVE

Muaji i Ramazanit është një mundësi e artë për besimtarët musliman, vlera dhe rëndësia e të cilit është shumë e lartë në fenë Islame. Duke e marr parasysh këtë, Forumi Rinor Islam, gjatë këtij muaji i shumëfishon aktivitetet dhe llojshmërinë e tyre.

Motoja jonë e Ramazanit 2023 ishte **“Ramazani, muaji i arritjeve”**, e ndër aktivitetet që janë realizuar ne do të përmendim:

- Nën udhëheqjen dhe përgatitjen e FRI – dega Shkup, u përgatit **“Agjenda e Ramazanit”**, që në realitet është një program për organizimin e kohës dhe qëllimeve ditore të Ramazanit. Qëllimi i kësaj fletushke është menaxhimi sa më efikas i vetes gjatë muajit të Ramazanit.

- Në qytetin e Kumanovës Ramazanin e mirëpritëm duke zbuluar qytetin me **banderola**, të cilat u vendosën në vende të ndryshme të qytetit.

- **“Sureja Mulk Challenge”** ishte një aktivitet tjetër i realizuar përmes rrjeteve sociale. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte mësimi përmendësh i sures Mulk, që i ka 30 ajete. Për çdo dit pjesëmarrësit mësuuan nga një ajet, e që me përfundimin e muajit, ato përfunduan edhe memorizimin e kësaj sureje.

- **Iftare për student.** FRI – dega Shkup shtroi iftare për rreth 50 studentë në qendrën rinore të FRI në Shkup gjatë çdo dite të hëne.


- **Emisioni “Ritmi i ditës”.** Përgjegjësi i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun pranë FRI, Ebrar Sherifi, në prag të Ramazanit, prezantoi në emisionin “Ritmi i ditës” në të cilin u bisedua rreth aktiviteteve të FRI në përgjithësi dhe veçanërisht rreth atyre të Ramazanit.

- **“Mukabele për Ramazan”** ishte një aktivitet i FRI – dega Kumanovë, i realizuar nëpërmjet platformës Zoom. Në këtë aktivitet u bë leximi i hatmes së Kuanit të Madhërisëm.

- Gjatë këtij muaji platformat tona në rrjetet sociale gjithashtu na kanë shoqëruar me **përkujtues** të ndryshëm të shpeshtë.

- Për të kremtuar fillimin e Ramazanit, FRI – dega Kumanovë realizoi **shpërndarjen e hurmave dhe fletëurimeve në prag të iftarit.** Shpërndarja e dhuratave u bë në pika të ndryshme të qytetit të Kumanovës.

- **Dhurata për Ramazan** u shpërndanë edhe në qytetin e Tetovës, ku aktivistët tonë bënë shpërndarjen e ëmbëlsirave, fletëurimeve, si dhe fletushka të ndryshme me lutje dhe mesazhe rreth Ramazanit.



- Aktiviteti **“Mirë se erdhe Ramazan”** edhe këtë vit u realizua në çarshinë e Shkupit, përpara xhamisë Murat Pashë. Ky aktiviteti i cili, veçmë është bërë një aktivitet tradicional i FRIsë, përmban recitim të ajeteve të Kuranit të Madhërishëm, fjalime, ilahi dhe pika të ndryshme artistike fetare. Në fund të aktivitetit u bë edhe shpërndarje e dhuratave për të rriturit dhe fëmijët.

- **“Melhemet e Ramazanit”** ishte një aktivitet tjetër që është realizuar nëpërmjet rrjeteve tona sociale. Në këto emisione, të cilët, përkrah rrjeteve sociale të FRIsë, u transmetuan edhe në kanale të ndryshme televizive, u trajtuan histori e dialogje të shumta me mysafir të ndryshëm.

- **“Shporta e Ramazanit”**. Edhe ky është një aktivitet tradicional që ka për qëllim solidarizimin me shtresat nevojtare të shoqërisë dhe me fëmijët me nevoja të veçanta. Aktiviteti “Shporta e Ramazanit” realizohet në qytetin e Kumanovës në bashkëpunim me shoqatën “Vllaznia”, si dhe në qytetin e Tetovës, në bashkëpunim me OH “Kalliri i Mirësisë”. Gjatë këtij aktiviteti shpërndahet një numër i madh i shportave me produkte ushqimore.

- **FRI shtroi iftarin tradicional në Shkup**, në të cilin morën pjesë një numër i madh i anëtarëve e aktivistëve të FRIsë, donatorë të shumtë, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe të OJQve, bashkëpunëtor, miq e dashamirë, nxënës dhe bursistë të FRI. Pas iftarit vijoi një program, i cili filloi me recitimin e disa ajeteve kuranore, e më pas fjala ju dha nënkryetares së FRIsë, Zuljeta Fetaovska. Fjalë rasti kishin edhe kryetari i komunës së Çairit, Visar Ganiu, kryetari i fondacionit AXIS, Rufat Sherifi si dhe kryetari i FRIsë, Xhabir Emini, i cili fjalën e tij e përqendroi në dhënien e disa këshillave.

- Për të biseduar rreth aktiviteteve të FRIsë gjatë dhe jashtë Ramazanit, kryetari i FRI – dega Tetovë dhe anëtar i kryesisë së degës, Ismet Tahiri, prezantuan në emisionin **“Pas dite”** në TV KOHA.

- Në bashkëpunim me Komunën e Likovës u shtrua **iftar i përbashkët në Sllupçan të Kumanovës**. Pjesëmarrës në këtë iftar ishin udhëheqës të Komunës së Likovës, anëtarë e aktivistë të FRIsë, familje të dëshmorëve, invalid të luftës, imam të xhamive, donatorë, përfaqësues të institucioneve shtetërore, miq e dashamirë të FRIsë. Pas iftarit vijoi edhe një program me ilahi dhe fjalime, ku fjalë rasti kishte kryetari i FRIsë, Xhabir Emini dhe kryetari i Komunës së Likovës, z. Erkan Arifi.

- Nën moton **“Ramazani, muaji i arritjeve”**, FRI – dega Prilep, realizoi **kuizin e diturisë “Ikra”**. Në këtë kuiz morën pjesë një numër i madh i rinisë së fshatit Cërrnilishtë. Për të gjithë pjesëmarrësit u ndanë lëvdata ndërsa tre finalistët u shpërblyen me dhurata.





- Në bashkëpunim me OH "Kalliri i Mirësisë - Kërçovë", FRI – dega Kërçovë shtroi iftarin tradicional me nxënës, studentë, miq e dashamirë. Para iftarit umbajte ligjëratë me dr. Kujtim Kasami, i cili ndau disa këshilla rreth përgatitjes për 10 ditët dhe netët e fundit të Ramazanit.

- FRI – Kumanovë shtroi **iftare të ndryshme me anëtarët dhe aktivistët** e degës së Kumanovës. Këto iftare u shtruan në hapësirat e FRI – dega Kumanovë dhe shpeshherë u shoqëruar me aktivitete tjera të lira.

- Me prezencën e nxënësve, studentëve, mysafirëve, përfaqësuesve të Komunës së Tetovës dhe Zhelinës, rektorit të USHTsë, profesorëve e hoxhallarëve, anëtarëve e aktivistëve të FRI-së, **FRI – dega Tetovë shtroi iftarin tradicional**. Fjalë rasti në këtë iftar kishte kryetari i degës së FRI në Tetovës, Mevlan Abazi si dhe Rektori i USHT, prof. dr. Kushtrim Ahmeti.

- Në bashkëpunim me OH "Kalliri i Mirësisë" FRI – dega Prilep gjithashtu ka shtruar **iftar me maturantë, nxënës, profesorë dhe personalitete të sferave të ndryshme**. Fjalë rasti në këtë iftar kishte kryetari i FRI – dega Prilep, Veton Ibrahim, sekretari gjeneral i FRI-së, Abdulhamid Mustafa si dhe një përfaqësues i OH "Kalliri i Mirësisë".

- Në bashkëpunim me Komunën e Sarajit, FRI – dega Shkup shtroi iftar për një numër të madh të pjesëmarrësve. Fjalë rasti në këtë aktivitet kishte përfaqësuesi i këshillit komunal, Musa Alili, si dhe kryetari i FRI – dega Shkup, Afrim Demiri.

- **"Iftar i përbashkët në Komunën e Kumanovës"**. Në këtë iftar morën pjesë një numër i madh i intelektualëve, aktivistë e anëtarë të FRI-së. Fjalë rasti pas iftarit kishte kryetari i FRI – dega Kumanovë, Erduan Kurtishi, si dhe kryetari i Komunës së Kumanovës – Maksim Dimitrievski.

- **"Koncerti i Bajramit"** ishte një aktivitet që u realizua në qytetin e Kumanovës, në bashkëpunim me shoqatën "Vllaznia" për të mirëpritur festën e Bajramit. Programi filloi me recitim të ajetave nga Kurani Fisnik për të vazhduar programi i pasur me pika artistike nga artistë të ndryshëm si: Armend Beqiri, Avni Nebiu, Menduh dhe Deniz Allajbeg si dhe Nderim Alimi. Më pas vijoi këndimi i tekmbireve dhe salavateve si dhe lansimi i fishekzjarrëve dhe shpërndarja e çokollatave.

- **"Kokteji i Bajramit"** u realizua në degën e Shkupit dhe të Kumanovës, me anëtarët dhe aktivistët e degëve. Në këto takime, pjesëmarrësit uruan njëri-tjetrin për festën e Bajramit, duke i begatuar takimet me dhurata.

- **"Ngjarja ime preferuar"**, ishte një aktivitet tjetër i realizuar nëpërmjet mediave. Në këto video të shkurtra, nxënësit tanë ndanin me ndjekësit tonë ngjarjet e tyre të preferuara nga historia islame.





SHKOLLA EDUKATIVE "HAXHI NAZIM XHAFERRI"

Gjatë këtij viti ky projekt edukativo-fetar shënon modulën e tretë të realizimit të tij me një laramani aktivitetesh ku më të rëndësishmet do t'i veçonim: programin edukativ për mësimin dhe leximin e Kuranit Famëlartë, program edukativ të mësim besimit, program edukativ të etikës dhe kulturës, program edukativ të rregullave bazë të Islamit, krijimtari, aktivitete të lira dhe mësim nëpërmjet lojrave argëtuese si dhe vizita të institucioneve të ndryshme dhe ekskurziona.

Rreth 80 kursistë të shkollave fillore dhe të mesme nga Kërçova me rrethinë u bënë pjesë e këtij projekti. Gjithashtu para një viti pjesë e programit tonë u bënë edhe gratë dhe vajzat e reja të cilat ndjekin me vullnet dhe dëshirë të lartë kurset dhe trajnimet që ofrojmë. Vlen të theksohet që aktivitete me filloristë dhe nxënës zhvillohen gjatë fundjavës ndërsa aktivitetet me gra dhe vajza gjatë javës (e martë, e premte).

Përveç aktiviteteve javore ShE "Haxhi Nazimi Xhaferrri" shënon edhe ditët ndërkombëtare, si: **Festat kombëtare** (22 dhe 28 Nëntor), **1 Qershori** (Dita Botërore e Fëmijëve), **3 Dhjetori** (Dita Botërore e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta), **7 Marsi** (Dita e Mësuesit) si dhe aktivitetet e muajit të Ramazanit, Fitër Bajramit dhe Kurban Bajramit. Gjithashtu gjatë vitit akademik realizojmë edhe fushatën **"Ta njohim Muhamedin Alejhi Selam"** nën moton **"Çfarë di, çfarë dua të di dhe çfarë duhet të di për Pejgamberin tim"**.



Qëllimi i këtij projekti është ngritja dhe avancimi i fëmijëve në aspekt edukativ, orientimi i tyre drejt një vizioni më të qartë jetësor si dhe nxitja dhe motivimi i tyre për zhvillim një zhvillim të mirëfilltë personal.





AKTIVITETET E BRENDSHME

Përveç aktiviteteve të hapura që realizohen me publikun e gjerë, FRI realizon edhe disa aktivitete të brendshme, me anëtarët e kryesive të degëve dhe aktivistët. Këto aktivitete përfshinë: kuvende, pjesëmarrje nëpër aktiviteteve të organizatave tjera, prezantim nëpër emisione televizive, mbremje imanore, etj.

- FRI – dega Shkup realizoi **kuvendin raportues për vitin 2022**, në të cilin u shqyrtuan aktivitetet e kësaj dega nga komisionet mbikëqyrëse. Në emër të kryesisë së degës, raportin e aktiviteteve e bëri kryetari i degës së FRI – dega Shkup, Afrim Demiri. Në fund të raportimit të tij u bë edhe miratimi i këtij raporti.

- Përgjegjësi i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun pranë FRI-së, Ebrar Sherifi, morri pjesë në prezantimin e projektit të BE-së **“BE për lirinë e shprehjes: harmonizimi i legjislacionit kombëtar të medias me ligjin e BE-së dhe standardet evropiane të medias”**, që u organizua nga Delegacioni i BE-së dhe Ministra e Shoqërisë Informative dhe Administratës, në Shkup.

- FRI – dega Tetovë realizoi **kuvendin raportues të vitit 2022**, ku u raportua për aktivitetet që kjo degë i realizoi gjatë këtij viti. Pas formimit të komisioneve mbikëqyrëse, kryetari i degës së FRI – Tetovë, bëri prezantimin e raportit. Të pranishmit kishin mundësi për pyetje dhe debat, ndërsa në fund u bë edhe miratimi i këtij raporti.

- Mr. Vullnet Selmani, nënkryetari i FRI-së, morri pjesë në **kuvendin e përgjithshëm të Federatës Ndërkombëtare Islame të Organizatave Studentore (IIFSO)**, ku marrin pjesë mbi 100 organizata nga mbi 60 shtete të ndryshme të botës. Përveç prezantimit të aktiviteteve të FRI-së, u morr pjesë edhe në votimin për sekretar gjeneral të organizatës për mandatin e ardhshëm.

- FRI – dega Shkup në kuadër të aktiviteteve dyditore të seminarit të realizuar në Tiranë, përpiloi edhe **planin strategjik për vitin 2023/24**.

- Forumi i të Rinjve Muslimanë në Evropë dhe Organizatave Studentore (FEMYSO) ndau çmimin **“Best Collaboration”** për FRI-në në bashkëpunim me shoqatën “Ardhmëria” si pjesë e çmimeve **“European Muslim Youth Award”**, të cilët u ndanë në asamblenë e përgjithshme të FEMYSO. Në emër të FRI-së çmimin e pranoi Erduan Kurtishi, kryetar i FRI – dega Kumanovë.

-Në Qendrën e FRI-së në Shkup, në prani të kuvendarëve nga e gjithë Maqedonia, u mbajt **kuvendi raportues i XVII** me rradhë për vitin 2023. Pas debatit dhe diskutimeve nga kuvendarët, i njëjti raport u votua dhe me shumicë.



- FRI prezantoi në emisionin **“Ritmi i ditës”**, në të cilin ishte i ftuar përgjegjësi i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun pranë FRI-së, Ebrar Sherifi. Biseda në këtë emision u zhvillua rreth aktiviteteve të FRI-së, duke u fokusuar te “Mozaiku rinor” dhe aktivitetet e Ramazanit.

- Forumi Rinor Islam edhe këtë vit ka vazhduar me realizimin e aktivitetit sportiv **“Liga futbolistike e FRI-së”** aktivitet i cili përmban ndeshje mes degëve në qytetet ku vepron FRI. Ky aktivitet realizohet me qëllim të njohjes së anëtarëve mes vete.



TAKIME RINORE

Takimet me të rinjtë, të cilat përfshinë takime edukative, takime profesionale, takime të orientimeve profesionale, janë gjithashtu pjesë e aktiviteteve të realizohen me të rinjtë, duke vënë përpara tyre personalitete të shquar, nga të cilët mund të përfitojnë, qoftë përmes eksperiencave të tyre apo diturisë që ato kanë përfituar. Nga këto takime do të përmendim:



– **“Kush je ti?”**, me Ramazan Tamer, profesor, edukator dhe shkrimtar nga Republika e Turqisë. Në këtë ligjëratë u trajtuan temat e formimit të identitetit dhe mbrojtjes së tij.



– **Trajnimi për CV dhe Letër Motivuese**, me mr. Vullnet Selmani, i cili ligjëroi temën “Si të shkruajmë CV dhe letër motivuese” para të rinjve tetovarë.



– Trajnimi **“Me çfarë do të ballafaqohem si nxënës i shkollës së mesme?”**. Ky trajnim u realizua me nxënësit e klasave të nënta të qytetit të Shkupi dhe Kërçovës, para së cilëve ligjëroi prof. Edlira Destani.



– **“Si të kujdesemi për shëndetin mental gjatë studimeve”**, me prof. Musa Musai, i cili ligjëroi në Shkup para të rinjve që ndjekin studimet universitare.

SHËTITJE DHE KAMPINGJE

Forumi Rinor Islam, ndër të tjera, realizon edhe shëtitje dhe kampingje me anëtarët, aktivistët dhe nxënësit që marrin pjesë nëpër projektet tona. Disa nga këto shëtitje e kampingje të cilat janë realizuar gjatë vitit 2023 janë:

- **Shëtitja në Kodrën e Diellit** me nxënësit e projektit "Eureka" dhe "Incept" nga qyteti i Shkupit, që u realizua në muajin janar 2023.

- **Kampingu dimëror i FRI – dega Kumanovë.** Ky ishte një kamping që u realizua gjatë fundjavës së fundit të muajit shkurt 2023, në Kodrën e Diellit, me anëtarët dhe aktivistët e degës së Kumanovës. Pjesë e aktiviteteve të këtij kampingu ishin lojërat dhe aktivitetet e ndryshme rekreative, këshilla dhe ligjëratat të shkurtëra, falja e përbashkët e namazeve.

- **Shëtitja njëditore e FRI – dega Kërçovë** me nxënësit dhe aktivistët në qytetin e Korçës dhe Pogradecit. Pjesë e kësaj shëtitje ishte edhe vizita e Mësonjëtores së Korçës dhe liqenit të Pogradecit.

- **Ekskursioni veror me nxënës, studente, anëtare e aktiviste të FRI-së në Turqi.** Ky ishte një aktivitet që u realizua në bashkëpunim me O.H. "Kalliri i Mirësisë", në të cilin u organizua në vizitë 5 ditore në qytetin e Stambollit. Agjenda e këtyre vizitave përfshinte vizita të monumenteve të ndryshme historike, xhamive, muzeve, institucioneve dhe organizatave të ndryshme.

- **Seminar dyditor i FRI – dega Shkup në qytetin e Tiranës, Shqipëri.** Ky seminar u realizua me anëtarët e kryesisë së degës së FRI – dega Shkup, ku ndër të tjera u realizua: përgatitja dhe përpunimi i planit strategjik, vizitë fondacionit "Mirësia", vizitë shkollës TES si dhe vizitë në shoqatën kulturore "Ardhmëria". U realizuan gjithashtu disa ligjëratat dhe këshilla nga prof. Tahir Zenelhasani, hoxhë Sabaudin Jashari dhe hoxhë Fevzi Musliu.

- **Ekskursioni njëditor i shkollës edukative "Haxhi Nazim Xhaferri".** Shkolla edukative "Haxhi Nazim Xhaferri" organizoi ekskurzion njëditor me karakter edukativ, rekreativ dhe sportiv, me nxënësit që ndjekin kurset e kësaj shkolle edukative. Për fëmijët u organizuan lojëra të ndryshme edukative, sfiduese, futboll, vrap, shpërblime si dhe ushqimi i përbashkët. Ndërkaq para grave fjalë rasti kishte përgjegjësja dhe edukatorja.



VIZITA

Vizitat zyrtare që kryesia e FRI-së realizon janë disa nga rrugët për ndërtimin e urave të bashkëpunimit dhe mirëkuptimit institucional, gjë e cila shërben në nxjerrjen në pah të aktiviteteve dhe organizimeve të reja për të mirën e rinisë dhe shoqërisë sonë.

Nga vizitat tona gjatë këtij viti janë:

- **Vizita nga autoshkolla "Hirda"**, gjegjësisht drejtori i kësaj autoshkolle, Idahi Hirda. Vizita e tyre u realizua në njërën nga takimet e projektit "Talentium" në qytetin e Shkupit, ku ato njoftuan nxënësit rreth rëndësisë së komunikacionit dhe prezantuan ofertat e tyre të volitshme. Stafii i autoshkollës ndau edhe disa dhurata për nxënësit.

- Vizitat që kanë realizuar nxënësit dhe përgjegjësit e "Mozaikut rinor", e ndër to janë: **vizita nëpër kanale televizive të Maqedonisë së Veriut, vizitë në Kryqin e Kuq, vizitë zjarrfikësve, etj.**

- **Vizita në Komunën e Likovës** nga kryesia e FRI – dega Kumanovë në krye me kryetarin e degës, Erduan Kurtishi, të cilët u mirëpritën nga kryetari i komunës, Erkan Arifi. Të dyja palët shprehën falënderim për bashkëpunimin në të kaluarën dhe gatishmëri për të realizuar edhe më shumë aktivitete në të ardhmen.

- **Vizita në shkollën e mesme të qytetit të Shkupit "Zef Lush Marku"**, me rastin e Ditës së Mësuesit, nga delegacioni i kryesisë së FRI – dega Shkup, në krye me kryetarin e degës, Afrim Demirin, për të ndarë mirënjohjen post-mortum për prof. Faruk Zeqiri.

- **Vizita në Ministrinë e Kulturës.** Kryetari i FRI, Xhabir Emini, dhe sekretari gjeneral, Abdulhamid Mustafa, kryen vizitë në Ministrinë e Kulturës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilët u mirëpritën nga zëvendës ministri, z. Daim Luci, të cilin FRI i ndau mirënjohje për bashkëpunim korrekt dhe për kontributin e dhënë në realizimin e aktiviteteve kulturore-edukative. Në emër të ministrisë, z. Luci ofroi mbështetjen për aktivitetet tona edhe në të ardhmen.

- **Vizita e FRI – dega Shkup në fondacionin "Mirësia" dhe shoqatën kulturore "Ardhmëria"** në Shqipëri.



AKTIVITETET E ZMP

Aktivitetet e ZMP, botimet dhe publikimet, kanë parasysh mesazhe dhe objektiva, në mënyrë që cdo aktivitet të shfaqet në mënyrë të qëndrueshme për ndërtimin e një imazhi pozitiv duke gjeneruar vullnet midis audiencave të ndryshme.

Dita **më e lavdëruar** është **dita e xhuma**, andaj **sa më shumë** më çoni **salavat** ngase **salavati juaj më paraqitet mua.**



Zyra për marrëdhënie me publikun pranë FRI-së ka vazhduar të jetë aktive duke shpërndarë ne rrjetet sociale:

Reelsa të ndryshëm mbi aktivitetet, postera njoftues, përkujtues / porosi profetike, Salavati i ditës së xhuma, letra ngushëlluese, urime për ditë të veçanta kombëtare dhe fetare, komunikata të ndryshme, përkujtuesit gjatë muajit Ramazan (ajeti, hadithi dhe duaja e ditës), emisioni Melhemet e Ramazanit, agjenda e Ramazanit, video 'Ngjarja ime e preferuar' dhe shënimi i ditëve botërore si "1 shkurti – Dita nderkombetare e mbuleses".

- Poashtu këtë vit ZMP për të gjithë ndjekësit e saj ka realizuar një serial të emisioneve nën moton **Mesazhi Javor**. Ky serial emisionesh është fokusuar në temat dhe vlerat që përfaqësojnë islamin dhe ka sjellë këndvështrime të ndryshme mbi tema që tangojnë shoqërinë në përgjithësi e rininë në veçanti.

- FRI promovoi librin **"Me Naimin gjer te Naimi"** e cila mban logon botuese të Forumit Rinor Islam. Libri në fjalë paraqet përmbledhje të disa shkrimeve origjinale dhe kontributeve të tjera, të përgatitura për botim komplet me rastin e shtatëdhjetë vjetorit të lindjes së autorit.



FRI
FORUMI RINOR ISLAM

MESAZHI JAVOR
EPISODI NR.6

Mëshira e Zotit, gëzon zemrën e besimtarit!

Ligjërues:
Hoxhë Mevlan Abazi





“TË NXISIM DIJEN, TË INVESTOJMË PËR ARDHMËRINË”



**FORUMI RINOR ISLAM
2023**

FLEKSIBILITET | PËRKUSHTIM | ARRITJE

www.fri.org.mk

